

# AKT - THEMELIMI

I

## SHOQËRISË TREGËTARE "AN-SI" sh.p.k.

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" sot me date 05.01.2022, krijohet shoqëria tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar "AN-SI" sh.p.k. me aktin themelues të saj si vijon:

### FORMIMI

#### NENI 1

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar "AN-SI" sh.p.k. me themeluesit:

- 2- Z. Bardhyl Dalipaj i biri i Hetem, i datelindjes 25.07.1960, lindur ne Dames me nr.personal leternjoftimi G00725061S dhe banues ne Tirane;

### SELIA E SHOQËRISË

#### NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private "AN-SI" sh.p.k., do të jetë në adresën Rr. Ibrahim Kodra, Lagjia Nr 5 ,Kulla 7, Hyrja 38, Tirane;

Ajo mund të çelë edhe adresa sekondare të tjera, përfaqësime dhe agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të

organeve kompetente edhe jashtë vendit. Të gjitha këto me vendim të ortakëve themelues të saj.

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

### **NENI 3**

#### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:**

Blerje dhe shitje me shumice dhe pakice te pajisjeve mjekesore. Blerje shitje kite, reagente, materiale mjekesore me shumice dhe pakice.Import-eksportme shumice dhe pakice te maskave te llojeve te ndryshme mbrojtese kunder Covid-19. Import-Eksport te kiteve, reagenteve, materialeve mjekesore.Tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te para dhe produkteve farmaceutike ne farmaci dhe spitale private e shteterore.Shitje me shumice dhe pakice te konfeksioneve, uniformave mjekesore. Transport mallrash dhe produktesh per subjekte te ndryshme. Sherbime nderhyrese higjeno sanitare shendetesore : Sherbime Pest Control (DDD - Dezinfektim, Dezinsektim,Deratizim),

### **NENI 4**

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hap objekte prodhimi, njesi sherbimi dhe tregëtimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj.

## **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

### **NENI 5**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete me një afat të pa caktuar mbi 10 vjet. Shoqëria mund të shpërbëhet në cdo kohë dhe për cdo lloj shkak.

### **NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke, dhe zotërohet nga ortakët si më poshtë:

- **Bardhyl Dalipaj** zotëron 100% te kapitalit **ne vlerë 100.000 lekë e ndarë në 1 kuotë**

### **NENI 7**

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

#### **NENI 8**

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'ua ketë ofruar për blerje ortakut brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që i'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

#### **NENI 9**

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje **"AN-SI" sh.p.k.** niptin, adresën.

#### **NENI 10**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- **Asambleja e Ortakeve** përbërë nga:  
**1- Z. Bardhyl Dalipaj**
  
- **Administratori i Shoqërisë** do të jete **Z.Bardhyl Dalipaj** me një afat 5-vjecar me të drejtë ripërsëritje

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

#### **NENI 11**

Administrator i shoqërisë **"AN-SI" sh.p.k.** është **Z.Bardhyl Dalipaj** i biri i Hetem datëlindjes 25.07.1960, lindur në Dames dhe banues në Tirane

#### **NENI 12**

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka

llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.

### **NENI 13**

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim Ortakeve në përpjestim me kontributin e tyre në kapitalin themeltar, mbasi të jenë likujduar të gjitha detyrimet dhe të jetë hequr fondi i rezervës ligjore.

### **NENI 14**

Ky akt u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë.

Akti u përpilua në tre kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit, zyrën noteriale, tatim - taksa dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

## **ORTAKËT**

**THEMELUESIT E SHOQËRISË "AN-SI" sh.p.k**

**BARDHYL DALIPAJ**

